



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 05.12.2023

NR.09/ 10100 /2023

ANEKS KONTRATË PËR PUNË

Numri i kontratës:¹ 659-23-13089-5-3-5/C489 & KKHE-23-034-5-2-1

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëzëri anë; dhe

ATC COM SH.P.K., Doganaj, Kaçanik, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë të shënuara me poshtë:

PUNE SHITES - Rregullimi i parkut të rruga Lepenci me numër identifikues: 659-23-13089-5-3-5

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **PUNE SHITES - Rregullimi i parkut të rruga Lepenci**

No.	Lot
1	PUNE SHITES - Rregullimi i parkut të rruga Lepenci

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **7,553.55 €**; [Shtatë mijë epesëqind epesdhjetë e tre Euro /55 centi] Euro. Kjo punë shtesë e ankes kontratës është 9.58% e vlerës së kontratës bazë në shumë prej: **78,834.10 €**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka bërë Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike,

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që përbëjnë kontratën konsiderohen se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në rast të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Neni 4**Komunikimet**


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues **KOMUNA HANI I ELEZIT**

Emri:	Xhevdet BUSHI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	05/12/2023
Vula:	

Për Kontraktuesin **ATC COM SH.P.K.**

Emri:	Arben MURSELI
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	05/12/2023
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-23-13089-5-3-5/C489

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vleres se kontrates ne afat prej 2 mujave.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [shëno shumat] ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat] ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat] ; (d) dëmtim personal ose vdekje: i. të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat] ii. të personave të tjerë: [shëno shumat]
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda [shëno numrin] ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është [shëno numrin] ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë menjeher pas nënshkrimit te kontrates.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë [30] ditë, apo një (1) muaj nga fillimi i punimeve.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë [shëno përqindjen e Çmimit përfundimtar të Kontratës 0.20%] për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është [10%] e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	[Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është [Adnan Lusnjani- Zyrtar per planifikim dhe zhvillim ne DUKMM- me E-mail add. adnan.lusnjani@rks-gov.net tel.049-880-464]., Per OE- Skender Loshi –inxhinier i ndertimtaris- drejtimi konstruktivë/.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: [shëno përqindjen]
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë menjeher pas pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është [shëno numrin] ditë,
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është [shëno përqindjen] .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Me marreveshje ne mes te AK dhe OE, ose Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë ose Ne te kunderten do te pasoj padia ne Gjykatën kompetente (do te llogariten te gjitha demet
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	[Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [specifikoni gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë. a) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].